

# Albana HOTI

## NOTERE

E-mail: albanahoti2916@gmail.com - hotialbana91@hotmail.com Adresa: Egnatia, Durrës, AL



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE DURRËS

NR. 1060 REF  
NR. 471 KOL.

### KONTRATE SHITJE

Sot, me datën 07 Maj 2019 (Dymijë e nëntermbledhjetë), para meje, noterës Albana Hoti, Anëtare e Dhoma Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Durrës, me NIPT K31601507J dhe liçence profesionale nr.235, me adresë: Durrës L.4 Rr."Egnatia" 405, u paraqiten personalisht shtetasit e poshte shenuar te cilet konform Ligjit Nr.110 date 20.12.2018 "Per Noterine ", bazuar ne ktiteret e nenit 101 te ketij ligji dhe nenit 105/2,pika "a" ,"b","c" te tij, e nenit 705 e vijues te Kodit Civil me kerkuar redaktimin e kontrates, se shqirblerjes se pasurise se pajunjtshme me kete permbajtje:

#### I. PALA SHITËSE:

**ERVIS DUMA, atesia Benjamin,** lindur ne Durrës me 31.01.1980, banues ne Lagjen Nr.2, Rr.Sefër Efendiu, Nr.147, Durrës, shtetas shqiptar, me zotësi te plote per te vepruar, identitetin e te cilit e verifikova me ane te kartes se identitetit 032691756/100131054D ORTAK ME NUMER AKSIONESH 49, PËRQINDIA NË KAPITAL NË 49.00%, ME KONTRIBUTI NË PARA 49.000,00, NE SHOQERINE " WORLD OF METAL " SH.P.K me NIPT L81527514K, te cilet ne kete kontrate do te cilesohet *si pala shitese*

#### II. PALA BLERËSE:

**GANI FERRIK ASLLANI,** lindur ne Novosele Vlora me 26.01.1953, banues ne Lagja nr 1 Rr.Faulamia, Durrës, shtetas shqiptar, madhor me zotësi juridike te plote per te vepruar, mbajtes i leternjoflimit me Nr. 029524177/ F30126108E, i cili ne kete akt perfaqesohet me prokore te pergjithshme Nr.Rep.641 Nr.Kol.366 date 26.03.2015, te Notere Albana H. Hoti, nga Z.KLODIAN ASLLANI, lindur ne Durrës, me 20.06.1977, banuese ne Lagja nr.1 . Durrës, shtetas shqiptar, madhor e me zotësi te plote per te vepruar, mbajtes i Leternjoflimit me Nr. 032153372/H70620090L . i cili ne kete kontrate do te cilesohet *si blerese.*

#### *Kushte te pergjithshme:*

Shoqeria "World of Metal" SHPK . eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, regjistruar ne Regjistrin Tregetar date 19/03/2018, me NIPT L81527514K . me seli ne DURRES XHAJZOTAJ XHAJZOTAJ AUTOSTRADA TIRANE - DURRES, RRUGA E FELAKES, KAPANON PRIVAT NJE- KATESH, 150 METRA NGA RRUGA NACIONALE, ne fushen e Prodhime dhe punime metalike te ndryshme fason me material porositesi per tu eksportuar ne vendin e origjines. Punime te ndryshme metalike hekuri, inox, alumini, druri etj. te destinuara per tregun e brendshem dhe te jashtem.Ushqimim e aktivitetit te import eksportit te te gjitha mallrave, teknologjive dhe pajisjeve dhe transport nderkombetar in sipas percaktimeve te Ekstraktit te regjistrit tregetarë leshuar nga Qkb-jaka nje nga Ortak e saj eshte dhe pala shitese Ervis Duma Numer aksionesh 40.00, Përqindja në kapital në 49.00 %, me Kontributi në para 49.000.00 ne Shoqerine " World of Metal" SH.P.K.

Palet kane rene dakord paraprakisht per kalimin e titullit te pronesise mbi kuoten dhe kapitalin e shoqerise sipas percaktimeve qe do te behen ne kete Akt shit-blerje, per masen dhe menyren e kalimit te kuotave Pales Blerese

Por sa me sipër dhe bazuar edhe ne nenin 73, te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008. "Per tregtarët dhe shoqerite tregtare" , i ndryshuar, nga ligji nr. 129/2014, "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9901, date 14.04.2008, "Per tregtarët dhe shoqerite te ndryshuar", . palet bien dakord si me poshte vijon:

#### *Neni 1*

#### **BLERJA E KUOTAVE NE SHITJE**

Sipas kushteve dhe afateve te kesaj Kontrate, ne Datën e nënshkrimit te saj, Pala Shitese i shtet Pales Blerese dhe Pala Blerese do te bleje nga Pala Shitese, Ortak me Numer aksionesh 49.00, Përqindja në

# Albana HOTI

## NOTERE

albanahoti2016@gmail.com - hotialbana01@hotmail.com - Adresa: L.L. Rr "Egnatia", Durrës - AL

**kapital ne 49.00 %, me Kontributi në para 49.000,00 ne Shoqerine " World of Metal" SH.P.K.,** qe ka ne pronesi e shoqerise sipas menyres se percaktuar me poshte:

Shitesi Ervis Duma, do t'i shesin Bleresit dhe Bleresi Gani ASllani do te bleje Numer aksionesh **49.00, Përqindja në kapital ne 49.00 %, me Kontributi në para 49.000,00,** nga Shitesi i kuotes, te kapitalit te shoqerise dhe çdo te drejte qe lidhet me to, te lira nga çdo Barre, me çmimin e blerjes dhe te pagueshme sipas menyres qe percaktohet po aty.

### NENI 2

#### ÇMIMI I BLERJES DHE MENYRA E PAGESSES

Çmimi total i blerjes se kuotave ne shitje eshte **20.000 leke (njezetemije lere)**, shume e cila eshte likujduar jashte kesaj zyre noteriale.

Me likujdimin e shumës se shitjes e cila do te vertetohet nepermjet mandat bankar, e drejta e pronesise mbi aksionet objekt kontrate shitje kalojne ne pronesi te vetme te pales blerese Ervis Duma.

### NENI 3

#### DEKLARIMET DHE GARANCITE

Pala Shitesë me ane te kesaj Kontrate deklarone dhe garantone ne lidhje me Shoqerine si dhe me transakcionin qe parashikohet ne kete Kontrate.

Pala Shitesë deklarone dhe garantone se shoqeria eshte krijuar dhe themeluar sipas ligjeve shqiptare, nuk eshte ne gjendje paaftesi paguese apo ne falimentim.

Pala Shitesë deklarone se jane ndjekur rregullish, te gjitha aktet ligjore dhe /ose procedurat e tjera te parashikuara nga legjislacioni shqiptar qe duhet te ndermeren nga ose per llogari te Shitesit dhe qe autorizojne Shitesin te lidhe dhe te zbatoje kete kontrate.

### NENI 4

#### PRONESIA

Pala Shitesë eshte pronar i vetem dhe i ligjshem i 49.00 % te kuotave qe perbejne kapitalin themeltar te shoqerise.

Kuotat ne shitje jane te lira nga çdo Barre e çfaredo lloji dhe Shitesja ka te gjitha te drejtat, kompetencen dhe autorizimin e plote per ti shitur, per t'i kaluar apo ransferuar dhe dorezuar kuotat ne shitje ne perputhje me afatet e Kontrates.

Nuk ka asnje Kontrate, marreveshje apo detyrim qe krijon apo vendos barre ne lidhje me kuotat ne shitje ose ndonje numer kuotash te autorizuar por te paemtuara ne kapitalin e Shoqerise. Asnje person nuk pretendon se ka te drejte mbi ndonje barre te mundshme te lidhur, me kuotat qe jane ne shitje.

### NENI 5

#### MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE

Me nenslikrimin e kesaj Kontrate, dhe plotesimit te kushtit, likujdimin total te vleres se shitjes nga pala blerese, ateher pala shitesë e humbet te drejten e pronesise mbi Numer aksionesh **49.00, Përqindja në kapital ne 49.00 %, me Kontributi në para 49.000,00.**

Ortaku i Shoqerise **Ervis Duma**, shpreh pronesine ne masen Numer aksionesh **aksionesh 49.00, Përqindja në kapital ne 49.00 %, me Kontributi në para 49.000,00 ne Shoqerine " World of Metal" SH.P.K.,** duke kaluar te drejten e pronesise Bleresit si ortakë i saj, Gani Asllani, i cili behet ortakë nga Numer aksionesh **49.00, Përqindja në kapital ne 49.00 %, me Kontributi në para 49.000,00,** duke u bere keshtu bashke ortak me Klodian Asllanin i cili ka Numer aksionesh **50.00, Përqindja në kapital ne 50.00 %, me Kontributi në para 50.000,00,**

### NENI 6

#### PREMTIME TE PERBASHKETA TE PALEVE



# Albana HOTI

## NOTERE

Email: albanahoti2016@gmail.com - hotialbana01@hotmail.com - Adresa: L.4. Rr "Egnatia", Durres - AL

Palet do ti sigurojne njera-tjetres, cdo dhe gjithë informacionin e nevojshem per perfundimin e ketij procesi.

### **NENI 7**

#### **LIGJI I ZBATUESHEM DHE JURIDIKSIONI**

Kjo kontrate rregullohet nga ligji shqiptar.

Te gjitha mos marreveshjet qe mund te lindin ndermjet palve ne lidhje me kete Kontrate do te zgjidhen me mirekuptim, ne rast te kundert kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e e rrethit Gjyqesor Durres.

### **NENI 8**

#### **TE NDRYSHME**

##### **8.1 Ndryshimet**

Cdo korigjim, ndryshim, zgjidhje apo heqje dore nga ndonje prej dispozitave te kesaj Kontrate, do te jete e vlefshme vetem ne qofte se behet me shkrim dhe nenshkruhet nga ose per llogari te seciles Pale.

##### **8.2 Vlefshmeria e pavarur nga njera tjeter e dispozitave kontraktore**

Ne rast se nje dispozite ose detyrim sipas kesaj Kontrate eshte i pavlefshem, i paligjshem ose i pazbatueshem ne nje juridksion, vlefshmeria ligjshmeria dhe zbatueshmeria e dispozitave ose detyrimeve te tjera, ose e ketyre detyrimeve ne nje juridksion tjeter, nuk do te preket ose cenohet nga nje fakt i tille.

Palet pranojne se do te perpiqen te zevendesojne nje dispozite te pavlefshme ose te pazbatueshme ne masen me te madhe te mundshme, per te permbushur qellimin e kesaj dispozite.

##### **8.3 Njoftimet**

Njoftimet ose komunikime te tjera sipas ose ne lidhje me kete Kontrate (Njoftimi) do te jene:

- Me shkrim
- Ne gjuhen shqipe
- Do te dorezohen ose dergohen me poste te shpejte me kthim pergjigje ose faks, pales qe duhet te marre njoftimin ne adresen e caktuar nga pala perkatese.

Me perjashtim te rastit kur provohet se njoftimi eshte marre me shpejt, njoftimi do quhet i dhene nese:

- Eshte derguar me poste, 10 dite pune, pas postimit te tij
- Eshte derguar me faks, kur konfirmimi i dergimit te tij eshte regjistruar nga faksi i derguesit.

##### **8.4. Kalimi i te drejtave**

Kjo Kontrate eshte detyrim ligjor dhe ne perfitim te paleve, trashegimtareve te tyre dhe personave te cileve u kalojne keto te drejta.

Bleresit nuk mund te kalojfte dhe transferojne te drejtat e tyre sipas kesaj Kontrate, plotesisht apo pjeserisht, pa miratimin paraprak me shkrim te Shitesit, miratim i cili nuk do te refuzohet pa arsye.

##### **8.5. Kostot dhe taksat**

Pervec kur parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, secila pale do te paguaje shpenzimet e saj ne lidhje me negocimin, hartimin, nenshkrimin dhe zbatimin e kesaj Kontrate dhe te shtojcave te saj (nese do kete). Te gjitha shpenzimet noteriale per nenshkrimin dhe zbatimin e kesaj Kontrate do te paguhen nga Pala Blerese.

##### **8.6. Teresia e Kontrates**

Kjo Kontrate perben marreveshjen e plote dhe zevendeson cdo marreveshje te meparshme midis paleve qe lidhet me objektin e kesaj Kontrate.

# Albana HOTI

## NOTERE

E-mail: albanahoti2016@gmail.com - hotialbana01@hotmail.com - Adresa: L. 4, Rr "Egnatia", Durres - AL

8.7 Kësaj "KONTRATE" i bashkelidhen si pjese perberese dhe e pandarë: Ekstrakti i QKB e pershkruara në Nenin I te kesaj "KONTRATE" së bashku me Vendimi i ortakeve, fotokopjet dokumenteve identifikues ,prokure e pergjithshme. (bashkengjitur si "Aneksi I").

8.8 KONTRATA" u hartua ne 4 (kater) faqe dhe në 4 (kater) kopje origjinale, ku nje kopje e merr pala shitese, nje kopje merren nga pala blerese, nje kopje depozitohet prane ZVRPP Durres, dhe njëra mbahet pranë kësaj zyre noteriale, dhe në origjinalin që arshivohet mbahet tarifa e pulles ne vleren 700 lek .

### 15. HYRJA NE FUQI E KONTRATES

8.9 Detyrimet dhe te drejttat qe burojne nga kjo "KONTRATE" fillojne efektet e tyre nga momenti i nenshkrimit te kesaj "KONTRATE" dhe regjistrimin e saj prane QKB.

\*\*\*\*\*


Ky akt u hartua nga une Noterja, akt te cilin pasi iu lexua dhe iu shpjegua te lartpermendurve, *deklarojnë se e kuptojne dhe janë plotësisht dakort me përmbajtjen e tij , e pranojnë këtë akt noterial, dhe me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë nënshkruajnë rregullisht në çdo faqe dhe në fund të aktit noterial vendosin emrin mbiemrin dhe nënshkrimin, para meje Noteres .*

Unë noterja vërtetoj në bazë të ligjit nr.110 datë 20.12.2018 " Për Noterinë ".

PALA SHITSE

*Ervis Dupa*  


PALA BLERESE

*Klodion Asthoni*  




NOTERE  
*Albana Hoti*

## Prokurë e Përgjithshme

Sot në Durres me date 26 të muajit Mars 2015 (dymije e pesëmbëdhjetë), ditën e Enjte, përpara meje noteres Albana H. Hoti, anetarë e dhomes Notereve Durres, me NIPT K31601507J dhe licënce profesionale nr.235, me adrese L.4 Rr."Egnatia" 405 Durres, u paraqiten personalisht shtetasit e mëposhtëm:

### POROSITESAT:

**GANI FERRIK ASLLANI**, lindur në Novosele Vlore, me 26.01.1953, banues në Lagja nr 1 Rr.Taulantia, Durres, shtetas shqiptar, madhor me zotësi juridike të plote për të vepruar, mbajtes i letërnjoftimit me Nr. 029524177/ F30126108E.

**BESNIKE HAXHI ASLLANI**, lindur në Kokeqvar, Durres më 10.09.1954, banuese në Lagjen Nr.1 Rr.Taulantia Durres, shtetas shqiptar, me zotësi të plote për të vepruar, Me Nr.Personal H40622059Q, njohur personalisht prej meje Noteres.

Te cilet me kërkuan hartimin e prokurës në kushtet e mëposhtëm:

"Emërojme dhe caktoj përfaqesuese të përgjithshme djalin tone **Z.KLODIAN ASLLANI**, lindur në Durres, me 20.06.1977, banuese në Lagja nr.1, Durres, shtetas shqiptar, madhore, e me zotësi të plote për të vepruar, mbajtes i Letërnjoftimit me Nr. 032153372/H70620090L, i cila ka të drejta dhe kompetenca të të plota të na përfaqsojë para personave të tretë publikë dhe privatë, institucioneve të administratës publike, Bashkise se Qytetit Durres, Gjykatave të tre shkalleve të gjikimit civil, administrativ, dhe penal, pranë cdo Banke të nivelit të dytë, Zyre Noterie, Zyre Vendore Regjistrim i Pasurise se Palujteshme Durres apo cdo qytet tjetër, në çdo vend tjetër që do të rezultojë e nevojshme në lidhje me veprime të ndryshme juridike dhe civile, shitje, blerje, dhurime, pranim dhurimesh, sipermarrje, deklarata të ndryshme, Kontrata Qiraje për tjetërsim pasurish të paluajteshme dhe të luajteshme në emrin tone, trasaksione të ndryshe bankare, .

Përfaqesuesi i porositur prej nesh ka të drejtë që për llogarinë tone dhe për të mbrojtur interesat e tona në zbatim të kësaj prokure:

- Të na përfaqsojë para të gjitha instancave të administratës shtetërore, Bashkise Durres, si dhe para të gjithë personave publikë apo privatë, për të kërkuar dhe paisur me dokumentacion ligjorë në emrin tone, për ceshtje të ndryshme që kanë lidhje me objektin e prokurës duke patur të drejtë të paraqesë akte dhe të tërheqë dokumenta, shkresa, apo kopje të tyre.
- Të paraqitet para cdo Zyre Noteriale për të nënshkruar në emrin tone cdo lloj kontrate tjetërsimi pasurish në emrin tone, si pale shitesë, pasuri keto të trashëguara apo të dhuruara dhe të vena gjate jetes tone bashkeshortore, si në favorin e tij apo personave të tretë, kontrata dhurimi, si në favorin e tij, apo personave të tretë, kontrata pranimi dhurimi, deklarata të ndryshme, Kontrata Qiraje çdo veprim tjetër që e sheh të nevojshëm në dobi të interesave të tona, duke patur të drejtën e caktimit të kushteve të këtyre kontratave apo akteve Të nënshkruaj deklarate noteriale, akte të ndryshme noteriale, aktin e pjestimit të pasurive për pjesët takuese, deklarata të ndryshme revokimi, kerkese për realizimin e objektit të kësaj prokure.
- Të na përfaqesojë para institucioneve të ndryshme private dhe shtetërore, të hy në negociata për shitjen e të gjitha pasurive të luajteshme dhe të paluajteshme,

te gjej bleresat, te caktoje emimin e shitjes, te paraqitet ne Zyre Noteriale p  
nenshkruar kontraten e shitjes te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme  
Te paraqitet prane ZVRPP Durres apo te kudo ndodhur per te depozituar akte  
ndryshme noteriale, kontrata shitje, blerje, deklarate noteriale etj, si dhe per te  
terhequr certifikata pronesia si dhe dokumentacione te ndryshme ne emrin tone.

Te na perfaqesoje prane cdo Banke te ndodhur ne territorin e Republikes se  
Shqiperise per te terhequr, depozituar shumate ndryshme monetare ne valuta  
te ndryshme, si dhe te depozitoje ose te terheqe cdo dokumentacion qe do te  
paraqitet i nevojshem per realizimin e objektit te kesaj prokure, si dhe te hape  
ose te mbylle llogari ne valuta te ndryshme ne emrin tone si:

Terheqja cash nga transaksionet e shitjeve te pasurive.

Derdhje cash

Transferta brenda llogarise, per te trete apo jashte vendit etj.

Pagesa te faturave te ndryshme.

- Te na perfaqesoje me te drejta te plota para cdo instance gjyqesore te cdo shkalle gjykimit, si ne Gjykatën e rrethit Gjyqësor Durres, Gjykate n e Apelit apo gjykatën e Lartë; duke na perfaqesuar para tyre ne ne cdo lloj seance gjyqesore, ne cdo lloj konflikti civil me cilesine e paditesit, te paditurit, kunderpaditesit, kunder te paditurit, si pale e trete, kerkues apo cdo gje tjeter qe ajo e shfaq te arsyeshme ne interesin tone, duke ngritur padi, kunderpadi, kerkesa me cdo lloj objekti pa kufi, duke nenshkruar ato ne emrin tone.
- Te kete te drejten e caktimit te Avokatve te ndryshem per mbrojtjen e interesave tona, si bashkepronar apo pronar te vetem, me te drejta te plota, duke patur te drejten e parashtes se provave te ndryshme shkresore, deshmitare, te kerkoje eksperte te ndryshem, ti kundërshtojte apo pranoje ata, te kete te drejta te beje kerkesa, prapsime, pretendime, ndryshimin e ndergjygesise, te drejten e ankimeve te ndryshme, si vendimeve te ndermjetme, vendimeve perfundimtare, deri ne ekzekutimin e tyre ne Zyren e Permbarimit me ane te kerkesave ligjore prane Gjykates se rrethit Gjyqësor Durres.
- Të paraqesë kërkesa të ndryshme administrative para organeve të administratës shtetërore dhe gjykatave duke patur të drejtën e disponimit për këto kërkesa në çdo shkallë të procedimit.
- Të paraqesë dhe nënshkruajë në emrin tone kërkesa, ankesa, ankime, rekurse si dhe çdo akt tjetër që e konsiderojnë të nevojshëm për mbarëvajtjen e porosisë së ngarkuar në prokurë.

Te gjitha veprimet e kryera nga ana e perfaqesueses tone per realizimin e plote te objektit te kesaj prokure te pergjithshme me afat te pa percaktuar, une i perfaqsuari i konsideroj te drejta dhe te mireqena njesoj sikur te ishin kryer prej meje personalisht, pasi ato do te kryhen konfrom rregullave dhe ligjeve ne fuqi.

Tagrat e mesiperme perfaqesuesja i ka deri ne perfundimin e porosisë, ekzekutimin e plotë të drejtave për të cilat është lëshuar prokura ose deri në revokimin e kësaj prokure nga ana ime me akt të njejtë sipas nenit 76/d i Kodit Civil ne Republikën e Shqiperise.

Prokura sipas kushteve të mesiperme u hartua në bazë të kërkesës së të perfaqesuarve, të cileve pasi ju lexua, shpjegua dhe e gjeti në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të pavesuar e nënshkruan pa rezerva dhe unë noterja e vërtetoj sipas ligjit.

Porositesit

Besnise Asllani

BAJ

Gen Asllani

NAJ

Notere

Alban H. Doli 2